



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 905/8 prot.

Datë 02.05.2024

V E N D I M
Nr. 434/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.05.2024, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankimit elektronik me nr. A/2024/3967, datë 15.04.2024 dhe me nr. 905/2024 Prot., datë 15.04.2024 e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me REF-97645-03-07-2024, me objekt “*Zgjerimi i sistemit AV*”, me fond limit 15,480,000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

Ankimues: Operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK me Nipt (M31904013D), me adresë Rruga e Dibrës, Njësia Administrative Nr.8, Vila nr.153, Kati i Parë, Zona kadastrale nr. 8360, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9, Yrshek, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I*****Vlerësimi paraprak***

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II***Rrethanat e çështjes***

II.1 Në datën 08.03.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me REF-97645-03-07-2024, me objekt “Zgjerimi i sistemit AV”, me fond limit 15,480,000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2024/3967, datë 15.04.2024 dhe me Nr.905/2024 Prot., datë 15.04.2024 e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.3. Me anë të shkresës nr.2220/3 prot., datë 19.04.2024, protokolluar me tonën me nr.905/3 prot., datë 22.04.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e ka refuzuar atë.

II.4. Me anë të shkresës nr.20 prot., datë 29.04.2024 me objekt “Kërkesë për tërheqje nga ankesa”, protokolluar pranë KPP-së me nr.905/5 prot., datë 29.04.2024, operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK njofton se: *“...Duke qenë se, nuk kemi më interes për këtë procedurë prokurimi dhe për të shmangur dëmtimin e interesit publik nga vonesat në realizimin e procedurës, kemi vendosur të tërhiqemi nga ankesa jonë[...]”*.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “QuantX IT Solutions” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me REF-97645-03-07-2024, me objekt “Zgjerimi i sistemit AV”, me fond limit 15,480,000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër ankimimi A/2024/3967, datë 15.04.2024 dhe me Nr.905/2024 Prot., datë 15.04.2024, të operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me REF-97645-03-07-2024, me objekt “*Zgjerimi i sistemit AV*”, me fond limit 15,480,000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

